

Dalës-Izazn:

Nr. -11-1656 Data 20.11.2023
Br. Datum

OBILIC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Komuna Obiliq
Opština Obilić - Municipality Obiliq



ZYRA E KRYETARIT
Kabinet Presednika – Office of the Mayor

Në bazë të nenit 11 dhe 13 Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 date 4 Qershor 2008) , si dhe në bazë të nenit 5, pika 2 dhe nenit 73, pika 1 e Statutit të Komunës së Obiliqit, Kryetari I Komunës nxjerrë këtë:

VENDIM

- I. Themelohet Komisioni Vlerësues për Çmimet për Mirënjohjen Publike, në Komunën e Obiliqit.
- II. Komisioni vlerësues për çmimet për mirënjohjen publike në Komunën e Obiliqit nga pika 1 e këtij vendimi (më tutje Komisioni vlerësues), ka këtë përbërje:
 1. Hajriz Bekteshi - ish-Kryesues i Kuvendit Komunal
 2. Hysni Mjeku - ish-shërbyes Civil/zyrtar publik I pensionuar
 3. Ganimete Aliu- Zyrtare për barazi gjinore
 4. Zelushe Kelmendi -përfaqësuese e OJQ
 5. Mexhid Krasniqi- Kryetar i Këshillit Lokal
 6. Faton Beka - përfaqësues nga grupet e qytetarëve komunitet jo-shumicë
 7. Bedri Gashi- përfaqësues nga Policia e Kosovës
- III. Komisioni vlerësues udhëhiqet me rotacion, sipas radhës së anëtarëve, për një periudhë njëvjeçare.
- IV. Komisioni vlerësues në baza vjetore, vlerëson kandidaturat për qytetarët apo grupet e qytetarëve si dhe përkushtimin e zyrtarëve komunal për dy çmime:
 1. “Çmimi Vjetor për Angazhimin Qytetar” dhe
 2. “Çmimi Vjetor për Zyrtarin e Dalluar Komunal”.
- V. “Çmimi Vjetor për Angazhimin Qytetar” i ndahet qytetarit apo grupit të qytetarëve për të njohur publikisht kontributin e tyre për punën dhe angazhimin për interesin e

përgjithshëm në komunitetin e tyre dhe të cilët janë angazhuar në mënyrë pro-aktive, për të promovuar kohezionin social të komunitetit dhe janë kampionë në adresimin dhe zgjidhjen e çështjeve të komunitetit.

- VI. “Çmimi Vjetor për Zyrtarin e Dalluar Komunal”, do t’i ndahet një ose më shumë zyrtarëve komunal për të vlerësuar publikisht përkushtimin e jashtëzakonshëm që ndërldhet me zhvillimin dhe zbatimin me sukses të planeve dhe politikave të komunës duke nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim marrjen lokale.
- VII. Komisioni vlerësues takohet në baza të rregullta në tremujorin e fundit të vitit, për të shqyrtuar propozimet për kandidatë për dy çmimet nga pika 7 e këtij vendimi.
- VIII. Komisioni vlerësues i dërgon Kryetarit të Komunës, raportin përfundimtar me propozimet për ndarjen e dy çmimeve nga pika 7 e këtij vendimit, deri me datë 15 dhjetor të çdo viti.
- IX. Komisioni vlerësues, harton rregullat e procedurave të Komitetit si dhe kriteret për dy çmimet nga pika 7 e vendimit.
- X. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Xhafer Gashi
Kryetar i Komunës së Obiliqit